



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr.1104 Prot.

Tiranë, më 22/07/2021

**V E N D I M**

**Nr. 135 , Datë 22 / 07 / 2021**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, germa a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>2</sup> mori në shqyrtim ankesën me nr. 06 Regj., datë 27.01.2021, të M. Q, kundër kundër Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë Tiranë, me pretendimin e diskriminimit për shkak të “përkatësisë në një grup të veçantë<sup>3</sup>”.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>4</sup>,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Subjekti ankues, M. Q, ka përfunduar programin e studimeve të ciklit të parë pranë Fakultetit të Shkencave Humane, në Kolegjin Universitar Jopublik/BEDER dhe zotëron diplomën “Bachelor” në Shkenca Komunikimi, me mesatare 9.2.

---

<sup>1</sup>Në vijim do t’i referohemi me akronimin LMD.

<sup>2</sup> Në vijim do t’i referohemi me akronimin KMD.

<sup>3</sup> Si studente e cila ka mbaruar studimet e ciklit të parë bachelor në Kolegjin Universitar BEDER/universitet privat.

Në vijim ankuesja shprehet se: *“Në vitin 2018 nisa studimet në master shkencor për Marketing Mediatik në Universitetin e Tiranës. Në muajin dhjetor 2018, pas protestës së studentëve, u vendos nga qeveria që të gjithë studentët e masterit me mesatare mbi 9.00 do të përfitonin një përgjysmim të tarifës. U interesova në muajin qershor 2019, kur dolën datat e pagesës së shkollës, pranë zyrës arsimore të Fakultetit ku studioja dhe më thanë që nuk përfitoja nga ky parashikim edhe pse mesatarja ime e bachelorit ishte 9.2 me arsyetimin se kisha përfunduar studimet në universitet privat. Duke mos gjetur zgjidhje për problematikën time as nga Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë dhe as nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, ku shkova për t’u sqaruar, u detyrova ta paguaj tarifën vjetore të studimeve të vitit të parë, në mënyrë që të mos penalizohesha për provimet e sezonit”.*

Ankuesja ka pretenduar se është trajtuar në mënyrë të pabarabartë dhe të padrejtë me studentët që kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve në universitetet publike, pavarësisht se plotësonte kriterin e notës mesatare mbi 9 (nëntë), pikërisht për faktin se ajo kishte diplomë bachelor të një universiteti jopublik/privat.

Në përfundim, subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të konstatojë diskriminimin ndaj saj nga ana e Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë, Universiteti i Tiranës, pasi ata e kishin përjashtuar atë nga e drejta e përfitimit të përgjysmimit të tarifës së kërkuar për studimet në ciklin e dytë të studimeve në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Neni 7 i LMD-së<sup>5</sup>, të ndryshuar, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.*

---

<sup>5</sup>Akronim për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Subjekti ankues legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 33, pikat 1 dhe 3, të LMD-së. Subjekti legjitimohet *ratione temporis*, në kuptim të nenit 33, pika 4, germa dh, të LMD-së.

Ankuesja gjithashtu, legjitimohet *ratione materia*, pasi pretendimet e saj *prima facie*, janë të tilla që bëjnë pjesë në kompetencat që ligji, i njeh Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për shqyrtimin e ankesës në kuptim të nenit 32, pika 1, germa a, të LMD-së, si dhe ankuesja ka provuar interesin e saj të drejtëpërdrejtë përsa i takon pretendimit për cënim të parimit të barazisë e trajtimit në mënyrë të barabartë e të padiferencuar me “kategorinë e studentëve” me të cilët krahasohet. (*Studentët që kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve në universitetet publike, me mesatare vjetore 9 -10*)

### **Përsa më lart, referuar neneve sipërcituar të LMD-së, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.**

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Nëpërmjet shkresës me nr. 185/1 prot., datë 08.02.2021 nga ana e KMD-së i është kërkuar informacion Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë Tiranë<sup>6</sup>, si palë kundër së cilës është paraqitur ankesa, lidhur me pretendimin e ankueses.
- Nëpërmjet shkresës me nr. 105/1 prot, datë 11.02.2021, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë ka dërguar parashtrimet e veta lidhur me pretendimet e ankueses, duke informuar si më poshtë vijon:

*“Për rastin e ankueses është vepruar sipas VKM nr. 780, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit, në programet e ciklit të dytë të studimeve, në insitucionet publike të arsimit të lartë”, pika 1/f ku shprehimisht citohet:*

*Studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të dytë të studimeve, sipas kategorive të mëposhtme, paguajnë 50% të tarifës vjetore të miratuar nga institucionet e arsimit të lartë publik: f) Studentët që fillojnë vitin e parë të ciklit të dytë të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë dhe që kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë me notën mesatare vjetore 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë).*

*Pra, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë nuk ka bërë asnjë akt diskriminimi ndaj ankueses, por ka zbatuar një Vendim të Këshillit të Ministrave që është në fuqi dhe i detyrueshëm për t'u zbatuar nga ana jonë”.*

---

<sup>6</sup> Për dijeni dërguar Këshillit të Ministrave dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 243 1078, e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al), web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

2. NËpËrmjet shkresës me nr. 185/3 prot., datë 09.04.2021 nga ana e KMD-së i është kërkuar informacion Këshillit të Ministrave<sup>7</sup>, si palë e përfshirë kryesisht në këtë proces, gjatë shqyrtimit të ankesës.

NËpËrmjet shkresës me nr. 2284/1 prot., datë 29.04.2021, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR), ka përcjellë parashtrimet e saj duke mbajtur qëndrimin se, bazuar në nenin 4 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, shteti garanton të drejtën për arsimim dhe për individët që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve, ose në një program të studimeve profesionale, por që nuk kanë mundësinë financiare për t’i përballuar ato. Këshilli i Ministrave (KM) është organi ligjor kompetent për nxjerrjen e akteve nënligjore për përcaktimin e kategorive të individëve që përfitojnë nga kjo e drejtë.

Përmes VKM nr. 780, datë 26.12.2018, synohet mbështetja financiare e kategorive të caktuara të studentëve që ndjekin studimet në ciklin e dytë, në institucionet publike të arsimit të lartë, për të cilat parashikohet edhe rimbursimi me fonde grand nga buxheti i shtetit për vlerën e tarifës vjetore të reduktuar, të ardhur si rezultat i uljes së tarifës vjetore të studimeve për këto kategori përfitueses studentësh.

Parashikimi i lehtësimeve financiare për të ndjekur studimet në ciklin e dytë, të kategorive të caktuara të studentëve, është pjesë e politikës së përgjithshme shtetërore për mbështetjen e vazhdueshme të institucioneve publike të arsimit të lartë me fonde nga buxheti i shtetit, me qëllim për të siguruar arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës, duke qenë se institucionet publike të arsimit të lartë financohen nga Buxheti i Shtetit ose nga burime të tjera të ligjshme.

MASR thekson faktin se, institucioni përgjegjës për hartimin e politikave financiare dhe vlerësimin e ndikimit në buxhetin e shtetit të nismave të caktuara që kërkojnë financim nga fondet publike, është Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE), e cila ushtron veprimtarinë e fushës së përgjegjësisë shtetërore edhe në administrimin e buxhetit të shtetit, në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.

MASR, vijon duke arsyetur se, ndodhur në këto kushte, propozimi për përcaktimin e kategorive të studentëve që ndjekin studimet në ciklin e dytë në institucionet publike të arsimit të lartë që përfitojnë nga e drejta e uljes së tarifave vjetore të studimit, është bërë me propozim të përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në mënyrë

---

<sup>7</sup> Nga Këshilli i Ministrave është kërkuar specifikisht:

- Ky diferencim që i bën VKM-ja sipërcituar, këtyre dy kategorive të studentëve, a ndjek një qëllim të ligjshëm, a është i arsyeshëm dhe ka një përligje objektive?
- Cilat janë faktet apo argumentet që janë marrë në konsideratë nga KM për një diferencim të tillë, në përcaktimin e gërmës f), të pikës 1, të kësaj VKM-je?

që të përcaktoheshin sa më drejt kategoritë e studentëve përfitues, në proporcion edhe me mundësitë financiare të parashikuara në buxhetin e shtetit për të përballuar rimbursimin e IAL-ve publike, si rezultat i reduktimit të të ardhurave të këtyre institucioneve nga ulja e tarifës vjetore të studimeve për kategorinë e studentëve përfitues.

3. Mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të kësaj ankese, Komisioneri me datë 10.05.2021<sup>8</sup> realizoi një seancë dëgjimore me palët në proces.

Seanca u zhvillua me praninë e përfaqësuesve të MASR<sup>9</sup>, I. A dhe E. A, të cilat mbajtën qëndrimin e shprehur me shkresën nr. 2284/1 prot, date 29.04.2021 dhe nuk paraqitën parashtrime shtesë<sup>10</sup>.

Subjekti ankues nuk ishte i pranishëm në seancë.

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

#### **A. Lidhur me me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë e të pafavorshëm.**

##### **A.1 Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm, të pretenduar nga subjekti ankues, kundrejt Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë Tiranë.**

VKM nr. 780, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit, në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë”, në pikën 1, germa f) të tij përcakton se:

“ 1. Studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të dytë të studimeve, sipas kategorive të mëposhtme, paguajnë 50% të tarifës vjetore të studimeve, të miratuar nga institucionet e arsimit të lartë publik:

... f) Studentët që fillojnë vitin e parë të ciklit të dytë të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë dhe që kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë me notën mesatare vjetore 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë).

Në pikën 2, të kësaj VKM-je përcaktohet se: “Studentët sipas kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pikës 1, të këtij vendimi, paguajnë tarifën vjetore të studimeve në masën 50%, pas paraqitjes së dokumentacionit vërtetues për statusin e tyre ligjor, me vendim të Bordit të Administrimit të institucionit publik të arsimit të lartë”.

<sup>8</sup> Referuar “Njoftimit për seancë dëgjimore” me nr. 185/4 prot., datë 28.04.2021, të Komisionerit.

<sup>9</sup> Referuar Autorizimit me nr. 2284/2 prot., datë 10.05.2021 të MASR.

<sup>10</sup> Fakt i konfirmuar nga MASR edhe nëpërmjet e-mailit të datës 31.05.2021, drejtuar KMD-së.

Bazuar në sa më sipër, si dhe në analizë të veprimeve të kryera nga Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë Tiranë (Fakulteti), Komisioneri vlerëson se:

Fakulteti, në praktikën e ndjekur lidhur me pagesat e tarifave vjetore në masën 50%, për studentët që përfitonin nga parashikimi ligjor i pikës 1, germa f) të kësaj VKM-je, ka zbatuar përcaktimet ligjore të këtij akti, të cilat janë detyruese për të.

Në këtë kontekst, Fakulteti nuk ka trajtuar në mënyrë diferencuese subjektin ankues, për sa kohë ky diferencim nuk vjen nga mënyra apo procedura e ndjekur për zbatimin e tij, por nga vetë akti, të cilin ka qenë i detyruar ta zbatojë.

Neni 116 i Kushtetutës, në pikën 1 dhe 3, të tij ka përcaktuar se, aktet normative që kanë fuqi juridike në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë janë:

*“a) Kushtetuta;*

*b) marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara;*

*c) ligjet;*

*ç) aktet normative të Këshillit të Ministrave.*

*Aktet normative të ministrave dhe të organeve drejtuese të institucioneve të tjera qendrore kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë brenda sferës së juridiksionit të tyre”.*

Neni 118, i Kushtetutës, ka parashikuar se:

1. *Aktet nënligjore nxirren në bazë dhe për zbatim të ligjeve nga organet e parashikuara në Kushtetutë.*

2. *Ligji duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, të përcaktojë organin kompetent, çështjet që duhen rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte.*

3. *Organi i autorizuar me ligj për të nxjerrë akte nënligjore, siç specifikohet në paragrafin 2 të këtij neni, nuk mund t'ia delegojë kompetencën e tij një organi tjetër.*

Pra, Këshilli i Ministrave është institucioni i autorizuar nga ligji dhe ka kompetencën për nxjerrjen e akteve nënligjore, të cilat janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjitha institucionet/organet shtetërore, të cilave iu drejtohet.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se, Fakulteti ka zbatuar VKM-në objekt shqyrtimi, i cili është një akt nënligjor i detyrueshëm për të dhe se, ankuesja nuk i është nënshtruar një trajtimi diferencues nga ana e Fakultetit. Në mungesë të një trajtimi të tillë, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e Fakultetit të Historisë dhe i Filologjisë Tiranë, për shkakun e pretenduar nga subjekti ankues, e për rrjedhojë nuk konstatohet se ka shkelje të dispozitave të LMD-së, nga ana e Fakultetit.

**A.2 Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe pafavorshëm të subjektit ankues nga pika 1, germa f) e VKM nr. 780, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit, në programet e ciklit të dytë të studimeve, në insitucionet publike të arsimit të lartë”.**

Lidhur me kriterin e vendosur, në germën f), të pikës 1, të VKM nr. 780, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit, në programet e ciklit të dytë të studimeve, në insitucionet publike të arsimit të lartë”, Komisioneri gjykon se institucioni përgjegjës, për nxjerrjen e këtij akti është Këshilli i Ministrave (KM).

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, jemi në kushtet kur trajtimi i padrejtë, i pabarabartë dhe më pak i favorshëm, krahasimisht për dy kategoritë e studentëve<sup>11</sup>, prezumohet se ka ardhur pikërisht si rezultat i zbatimit të këtij akti nënligjor.

Ligji nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në insitucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 1, germa c) e tij, ka përcaktuar se, arsimi i lartë është e mirë dhe përgjegjësi publike dhe ka për mision, të ofrojë mundësi të barabarta për të përfituar nga arsimi i lartë dhe të mësuarit gjatë të gjithë jetës.

Neni 2 i këtij ligji, ka përcaktuar qartazi se, qëllimi i tij është:

- a) të përcaktojë rolin e shtetit në arsimin e lartë;
- b) të përcaktojë misionin, objektivat kryesorë të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, rregullat e krijimit, organizimit, drejtimit, administrimit, financimit dhe mbylljes së institucioneve të arsimit të lartë;
- c) të krijojë një sistem të unifikuar të arsimit të lartë, kërkimit shkencor në insitucionet e arsimit të lartë, inovacionit bashkëkohor e konkurrues në hapësirën europiane të arsimit të lartë;
- ç) të krijojë mekanizma të qëndrueshëm të sigurimit të cilësisë në insitucionet e arsimit të lartë, në përputhje me standardet europiane;
- d) të vendosë arsimin e lartë mbi baza të qëndrueshme financiare, duke krijuar mundësinë për shfrytëzimin e burimeve të ligjshme të financimit;
- dh) të garantojë mundësi të barabarta, mbi bazën e meritës, për të gjithë individët që duan të ndjekin studimet në arsimin e lartë;
- e) të bazojë sistemin e arsimit të lartë mbi parimin e konkurrencës së lirë mes institucioneve të arsimit të lartë, personelit akademik dhe studentëve”.

---

<sup>11</sup> Kategoria e studentëve që kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve në IAL Publike (me mesatare vjetore të rezultateve nga 9-10) dhe vijojnë studimet në ciklin e dytë të studimeve po në IAL Publike dhe kategoria studentëve që kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve në IAL JoPublike/Private (me mesatare vjetore të rezultateve nga 9-10) dhe vijojnë studimet në ciklin e dytë të studimeve në IAL Publike.

Ky ligj në nenin 5, pikat 1 dhe 2, të tij, ka sanksionuar rolin e shtetit në arsimin e lartë, duke përcaktuar, ndër të tjera se:

*“1. Shteti ushtron funksione rregullatore dhe krijuese të institucioneve publike të arsimit të lartë, si dhe financon arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor.*

*2. Shteti, nëpërmjet organeve dhe strukturave përgjegjëse të tij, ka përgjegjësitë dhe detyrimet si më poshtë:*

*a) garanton autonominë dhe lirinë akademike të institucioneve të arsimit të lartë;*

*b) është përgjegjës për përcaktimin dhe monitorimin e standardeve në arsimin e lartë për hapjen dhe akreditimin e institucioneve e të programeve të studimit që ato ofrojnë;*

*c) vlerëson cilësinë dhe funksionimin e institucioneve të arsimit të lartë, përmes agjencive të tij, atyre të pavarura ose të huaja, duke bërë publik procesin dhe rezultatet e tij;*

*ç) vë në dispozicion fonde publike për mbështetjen e programeve të studimit ose fushave të caktuara të kërkimit shkencor, në përputhje me përparësitë e zhvillimit dhe interesave strategjike të vendit;*

*d) vë në dispozicion fonde publike për të garantuar aksesin në arsimin e lartë, sipas meritës, pavarësisht nga mundësitë financiare të individëve...”.*

*Sipas përkufizimeve të këtij ligji:*

*“Institucionet e Arsimit të Lartë” (IAL) janë personat juridikë që ofrojnë arsimim të lartë ose kualifikim profesional pas arsimit të mesëm dhe, sipas llojit të institucionit, edhe kërkim shkencor, si pjesë e sistemit të arsimit të lartë, të krijuar, dhe që ushtrojnë veprimtarinë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi”.*

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 *“Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”*, dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, me vendimin nr. 109, datë 15.02.2017 të Këshillit të Ministrave, (i ndryshuar me Vendim nr. 562, datë 31.07.2019), është krijuar Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL).

ASCAL është i vetmi institucion në Republikën e Shqipërisë që kontrollon dhe vlerëson cilësinë në arsimin e lartë. ASCAL kryen vlerësimin paraprak të cilësisë për Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL), njësitë e tyre dhe programet e studimit të të tre cikleve në kuadër të licencimit të tyre si dhe vlerësimin e jashtëm në kuadër të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit.

*“Akreditimi” është procesi i pavarur për vlerësimin e jashtëm të cilësisë, i cili përcakton nëse institucioni i arsimit të lartë dhe/ose programet e studimit, që ai ofron, përmbushin standardet e caktuara të cilësisë, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.*

Agjencia kryen vlerësime analitike dhe krahasuese për IAL, programet dhe fushat e studimit.

Veprimtaria e ASCAL<sup>12</sup> konsiston në:

---

<sup>12</sup> <https://www.ascal.al/sq/rreth-nesh/misioni-dhe-veprimtaria>

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al), web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)



- Vlerësimin e jashtëm të cilësisë për akreditimin e parë dhe periodik të institucioneve të arsimit të lartë e të programeve të studimit që ato ofrojnë;
- Monitorimin, vlerësimin e cilësisë akademike dhe përputhshmërisë me standardet e cilësisë së institucioneve dhe programeve të ofruara prej tyre, përpara vlerësimit për akreditim të parë dhe në vijim;
- Vlerësimin paraprak në kuadër të hapjes dhe/ose riorganizimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit me kërkesë të ministrisë përgjegjëse për arsimin;
- Vlerësimin paraprak dhe njohjen e programeve të studimit, të ofruara në institucionet shqiptare të akredituara të arsimit të lartë nga institucione të huaja të arsimit të lartë të njërit prej shteteve të Bashkimit Evropian, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Kanadasë dhe Australisë;
- Vlerësimin periodik, çdo tre vjet, të cilësisë së mësimdhënies në institucionet e arsimit të lartë dhe monitorimi i vazhdueshëm i tij përmes Sondazhit Kombëtar të Studentëve, në përputhje me udhëzuesit e saj;
- Vlerësimin e sistemeve të brendshme të cilësisë (auditimi) në institucionet e arsimit të lartë, në përputhje me udhëzuesit e saj dhe standardet e udhëzimet për sigurimin e cilësisë në hapësirën evropiane të arsimit të lartë;
- Vlerësimet tematike, analitike dhe krahasuese të institucioneve dhe/ose programeve të studimit, në funksion të politikave për arsimin e lartë, në mënyrë autonome ose me kërkesë të ministrisë përgjegjëse për arsimin.

Dokumenti kryesor për të gjitha proceset dhe procedurat e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë (IAL) është Kodi i Cilësisë së Arsimit të Lartë, i cili përcakton standardet shtetërore të cilësisë, të detyrueshme për zbatim prej institucioneve të arsimit të lartë.

Kodi i Cilësisë i miratur me VKM Nr. 531, datë 11.09.2018 është përmbledhje e standardeve shtetërore për sigurimin e cilësisë, për programet e studimit me karakter profesional, programet e ciklit të parë të studimeve Bachelor, programet e studimit të ciklit të dytë "Master profesional", "Master i shkencave" dhe "Master i arteve", si dhe për programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë. Për realizimin e proceseve të vlerësimit të jashtëm ASCAL dhe IAL mbështen në Kodin e Cilësisë.

Nga publikimet në faqen zyrtare të ASCAL-së<sup>13</sup>, rezultojnë të akredituara me vendimet përkatëse të Bordit Administrativ (BA), gjithsej 30 IAL në RSH, ndër të cilat:

- Kolegji Universitar "Beder", me vendim BA nr. 101, datë 10.11.2017 për periudhën kohore nga data 10.11.2017 deri me datë 09.11.2021.
- Universiteti i Tiranës, me vendim BA nr. 84, datë 27.10.2018 për periudhën kohore nga data 27.10.2018 deri me datë 26.10.2022.

Referuar sa më lart, Komisioneri vëren se:

<sup>13</sup> <https://www.ascal.al/sq/akreditimi/institucione-te-akredituara>

Të dy IAL, si Universiteti i Tiranës (IAL Publike), ashtu dhe Kolegji Universitar “Beder” (IAL Jopublike/Private), janë akredituar nga institucioni përgjegjës, ASCAL. Ata janë vlerësuar prej tij, se përmbushin çdo kërkesë dhe kriter ligjor të përcaktuar dhe të kërkuar nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, për sa i takon, vlerësimin të jashtëm të cilësisë për akreditimin e parë dhe periodik të institucioneve të arsimit të lartë e të programeve të studimit që ato ofrojnë, vlerësimin të cilësisë akademike dhe përputhshmërisë me standardet e cilësisë së institucioneve dhe programeve të ofruara prej tyre.

Subjekti ankues, si dhe gjithë kategoria e studentëve, që ndjekin studimet në IAL Publike, në një program të ciklit të dytë të studimeve dhe kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve në IAL Jopublike/Private, me notën mesatare 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë), përjashtohen nga e drejta për përfitimin e pagesës së tarifës vjetore të studimeve në masën 50% të saj.

Komisioneri konsideron se, parashikimi i lehtësive financiare, për kategorinë e studentëve që ndjekin studimet në ciklin e dytë, dhe kanë mbaruar ciklin e parë të studimeve me mesatare vjetore 9 (nëntë) - 10(dhjetë) është një masë pozitive me qëllimin për të nxitur dhe siguruar një arsim cilësor, mirëpo nuk është gjithëpërfshirës. Kjo për shkak se, përcaktimi i bërë në pikën 1, germa f) e VKM nr. 780, datë 26.12.2018 *“Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit, në programet e ciklit të dytë të studimeve, në insitucionet publike të arsimit të lartë”, trajton haptazi në mënyrë të diferencuar dhe të pabarabartë kategorinë e studentëve që ndjekin ciklin e dytë të studimeve në IAL Publike dhe kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve në IAL Jopublike/Private, nga kategoria e studentëve që ndjekin studimet në IAL publike dhe kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve në IAL Publike, pasi kriteri i mesatares duhet përmbushur nga të dyja kategoritë e studentëve.*

## **A. Shkaku i mbrojtur.**

Mbështetur në nenin 2<sup>14</sup>, të ligjit nr. 10221, date 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se subjekti ankues është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që perfshihet në *“shkakun e mbrojtur”*. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të

---

<sup>14</sup>“Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b)barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga cdo forme sjelljeje qe nxit diskriminim.”

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al), web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

krahasimit ndërmjet subjektit ankues dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur, apo në krahasim me parashikimet ligjore, në kushtet kur mungon krahasuesi.

Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtetësinë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

“Gjendja arsimore” si shkak diskriminimi, nënkupton nivelin individual të arsimit, arritjet në arsim, aftësitë, certifikatat dhe mundësitë në lidhje me arsimin të cilat një person posedon.<sup>15</sup>

Referuar nenit 1, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, “gjendja arsimore” konsiderohet si shkak i mbrojtur, pasi parashikohet si i tillë në LMD, si dhe subjekti ankues ka depozituar prova/dokumentacion që e mbart atë.

Në lidhje me pretendimin e ankueses për diskriminim lidhur me “përkatësinë në një grup të veçantë”, Komisioneri vlerëson se, subjekti ankues ka depozituar prova të cilat faktojnë se ajo ka përfunduar studimet e ciklit të parë bachelor në Kolegjin Universitar BEDER, universitet jopublik/privat, me notë mesatare vjetore 9 (nëntë) - 10 (dhjetë). Rrjedhimisht kjo gjë e lidh trajtimin që i bëhet ankueses dhe grupit në të cilin ajo bën pjesë, me gjendjen arsimore të saj, pikërisht për shkak të specifikës sipërcituar, që ajo posedon. Në këtë kontekst, Komisioneri vlerëson se “shkaku” për të cilin subjekti ankues dhe kategoria në të cilën bën pjesë, është trajtuar në mënyrë të diferencuar, është pikërisht **gjendja arsimore** e saj.

Një nga përkufizimet e cituara të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDN), është “veçoria personale” në bazë të së cilës, personat ose grupet e personave dallohen mes njëri-tjetrit. Sipas GjEDNJ, shkaku i diskriminimit është individual, karakteristik për një individ, dhe nuk duhet konsideruar si relevant në kuptimin e trajtimit të ndryshëm ose gjatë gëzimit të disa përfitimeve të caktuara<sup>16</sup>.

## **B. Lidhja e trajtimit të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm, me shkakun e mbrojtur.**

<sup>15</sup> Shih linkun në faqen zyrtare të KMD-së: <https://www.kmd.al/shkaqet-e-diskriminimit/>

<sup>16</sup> Handbook on European Non-discrimination Law’. EU FRA and CoE, 2010.97

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al), web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

Si rregull, me qëllimin për të përcaktuar nëse “subjekti ankues” apo grupi i veçantë që ajo përfaqëson, është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë apo të pafavorshme krahasuar me shtetas, individë apo grupe pesonash të tjerë, në një situatë të njëjtë apo të ngjashme me të, nevojitet “krahasuesi”.

Cështjet e diskriminimit kërkojnë që të vërtetohet nëse ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive për trajtimin ndryshe të evidentuar.

*“Përkatësia në një grup të veçantë”* përbën shkak, për të cilin ligji nr.10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, ofron mbrojtje.

Bazuar në dokumentacionin që disponon nga hetimi, Komisioneri vlerëson se ankuesja mbart shkakun e pretenduar.

Nga shqyrtimi i dokumenteve të administruara nga Komisioneri, rezulton se ankuesja është diplomuar<sup>17</sup> në vitin 2017 në IAL Jopublike/Private, Kolegji Universitar “Beder”.

Lidhur me sa më lart, Komisioneri ka vlerësuar se ankuesja është ekspozuar para një trajtimi të pabarabartë nga ana e KM nëpërmjet vendosjes së kriterit të VKM-së objekt shqyrtimi, që kategoria përfituese *“duhet domosdoshmërisht të ketë mbaruar studimet e ciklit të parë studimeve në një universitet publik”*, si një kriter pengues dhe përjashtues për të vijuar me të drejtën e përfitimit për pagesën e tarifës studimore në masën 50% të saj.

*Në kontekst të mbrojtjes ligjore që i garantohet individit lidhur me këtë shkak, Komisioneri është mbështetur në analizimin e legjislacionit kombëtar dhe atij ndërkombëtar, lidhur me këtë fakt.*

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Dispozita kushtetuese i garanton çdo personi të drejtën për arsim në mënyrë të padirencuar.

Sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t’u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Shqipëria ka nënshkruar e ratifikuar disa akte ndërkombëtare, që në thelb kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi, ndër të cilat është edhe Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, e cila jo vetëm që është pjesë e e legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë, por zë një vend të veçantë brenda tij. Konventa njeh dhe parashikon kufizime të përgjithshme

---

<sup>17</sup> Diploma nr. 00559, datë 24.10.2017 e Kolegjit Universitar “Beder”.

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al), web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

dhe kufizime specifike për të drejta të veçanta. Neni 14 i Konventës garanton barazinë “në gëzimin e të drejtave dhe lirive” të përcaktuara në të. Protokollin 12-të i saj ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe në fushëveprimin e tij sesa Neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja.<sup>18</sup>

Katalogu i të drejtave të mbrojtura nga Konventa përfshin kryesisht të drejta civile dhe politike. Përjashtim është bërë për disa të drejta të karakterit socio-ekonomik që konsiderohen thelbësore për ekzistencën e njeriut, të cilat iu shtuan tekstit origjinal të Konventës me Protokollin nr. 1. Në këto të drejta përfshihet dhe e drejta për arsim.

Neni 2 i Protokollit nr. 1, të Konventës, përcakton se: “*Askujt nuk mund t’i mohohet e drejta për arsimin*”. Konventa garanton veçanërisht mbrojtjen nga diskriminimi në arsim, si dhe krijon detyrime pozitive për shtetin. E drejta për arsim bën pjesë në kategorinë e të drejtave “të tjera” të mbrojtura nga Konventa, për kufizimin e të cilave shtetet palë duhet të krijojnë sisteme rregullatore për zbatimin efektiv dhe gëzojnë një hapësirë më të gjerë vlerësimi për kufizimin e tyre.

Duke iu referuar çështjes Ponomaryovi kundër Bullgarisë<sup>19</sup>, me kërkues A. Ponomaryov dhe V. Ponomaryov, të cilëve shteti bullgar u kishte kërkuar të paguanin një tarifë për shkollimin e nivelit të dytë të një institucioni arsimor publik, në ndryshim nga personat e disa kategorive të tjera<sup>20</sup>, GJEDNJ-ja është shprehur se, praktika e ndjekur nga institucionet arsimore të Bullgarisë përbënte shkelje dhe ishte diskriminuese, duke iu referuar nenit 14 të Konventës, të marrë së bashku me nenin 2, të Protokollit nr. 1, të saj.

E drejta për arsim reflektohet edhe në nenin 26 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut<sup>21</sup>, në të cilin thuhet: “*Të gjithë kanë të drejtë në arsim. Arsimi do të jetë falas, të paktën në fazat fillestare dhe themelore. Arsimi fillor do të jetë i detyrueshëm. Edukimi teknik dhe profesional do të vihen përgjithësisht në dispozicion dhe arsimi i lartë do të jetë njësoj i arritshëm për të gjithë në bazë të meritave... ”.*

Konventa e UNESCO/1960, kundër diskriminimit në arsim, mbron të gjithë qytetarët e shteteve palë nga diskriminimi në arsim për çdo lloj shkaku. Gjithashtu, ajo i kërkon shteteve të ndërmarrin masa për të formuluar, zhvilluar dhe zbatuar politika kombëtare të cilat promovojnë trajtimin e barabartë në çështje, që lidhen me edukimin.

---

<sup>18</sup> [https://www.echr.coe.int/Documents/Handbook\\_non\\_discr\\_iaw\\_SQL.pdf](https://www.echr.coe.int/Documents/Handbook_non_discr_iaw_SQL.pdf), faqet 47 dhe 49

<sup>19</sup> Kërkesa nr. 5335/05/ 28.11.2011 Ponomaryovi k. Bullgarisë.

<sup>20</sup> Ankuesit bënin pjesë në personat me shtetësi ruse dhe rezidencë në Bullgari, dhe kategoritë tjera përfshinin dhe shtetasit bullgari, ndër të tjera.

<sup>21</sup> Në nenin 26 thuhet: “*Të gjithë kanë të drejtë në arsim. Arsimi i lartë do të jetë njësoj i arritshëm për të gjithë në bazë të meritave*”.

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (1969<sup>22</sup>) e cilëson të drejtën e arsimimit si të drejtë universale. Kjo natyrë i vishet kësaj të drejte, sipas parashikimeve të nenit 13 të Paktit, pasi ajo shtrin garancinë për çdo individ pavarësisht nga mosha, gjuha, origjina ose status tjetër. Neni 13, pika 2 parashikon që: “2. Shtetet palë të këtij Pakti pranojnë se për të arritur realizimin e plotë të kësaj të drejte: ...c) Arsimi i lartë duhet të bëhet i hapur për të gjithë në mënyrë të barabartë sipas aftësive të secilit, me të gjitha mjetet e përshtatshme...”

Karta Sociale Evropiane (1961) është një akt ndërkombëtar i miratuar nga KiE, e cila plotëson parashikimet e KEDNJ-së, sa i takon të drejtave sociale dhe ekonomike. Kjo Kartë është rishikuar në 1996 dhe mbron të drejtat e konsideruara si gjenerata e dytë e të drejtave dhe nuk kanë gjetur vëmendje të njëjtë nga shtetet palë krahasuar me KEDNJ. E drejta për arsimim garantohet nga disa nene të Kartës, konkretisht nenet 7 dhe 19, të ratifikuara dhe nga Shqipëria.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e ka përfshirë të drejtën për arsim, si të drejtë kushtetuese në kreun e lirive dhe të drejtave ekonomike e social-kulturore.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si një institucion barazie i specializuar për mbrojtjen nga diskriminimi, në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ka si qëllim të sigurojë të drejtën e çdo personi për: “a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin.”

Në shumicën e çështjeve të diskriminimit, ankuesi e ka të vështirë apo të pamundur t’i mbledhë provat, ndonjëherë provat e drejtpërdrejta as nuk ekzistojnë. Subjektet që konsumojnë sjelljen diskriminuese nuk e pranojnë asnjëherë se kanë diskriminuar. Për të kompensuar këtë disavantazh të madh, legjislacioni ka parashikuar parimin e zhvendosjes së barrës së provës.

Parimi i zhvendosjes së barrës së provës është një parim i konsoliduar në legjislacionin e BE-së dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së. KEDS gjithashtu ka pranuar që në çështjet e diskriminimit, barra e provës nuk duhet të varet plotësisht nga ankuesi, por duhet të jetë objekt i një rregullimi të posaçëm.

I njëjti rregullim në lidhje me barrën e provës parashikohet edhe në nenin 82, pika 2 e Kodit të Procedurës Administrative, përcakton se: “Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.

---

<sup>22</sup> Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore datë 16.12.1969, ratifikuar nga shteti Shqiptar më datë 4 Tetor 1991.

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 243 1078, e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al), web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

Ky rregullim i posaçëm në lidhje me barrën e provës pasqyrohet në nenin nenin 33, pika 7/1 të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se : “7/1. Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim.”

Kodi i Procedurës Administrative dhe ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, kanë saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palëstjetër/organit publik, në këtë Këshillit të Ministrave, i cili duhet të provonte se subjekti ankues nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshme, për shkakun e pretenduar prej tij.

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni i ka transferuar barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se *prima facie* është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues.

Pasi personi që pretendon diskriminim krijon një prezumim të diskriminimit (*diskriminimi prima facie*), barra më pas kalon tek subjekti, i cili duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.
2. Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Nëse “diskriminuesi i pretenduar” nuk është në gjendje të provojë njërën nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjës për diskriminimin<sup>23</sup>.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij:

*“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”.*

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjektet kundër të cilëve është bërë ankesa të vihen në dijeni dhe i janë ofruar mundësitë që të japin

---

<sup>23</sup> [https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra\\_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018\\_en.pdf](https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf), fq.232.

shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga subjekti ankues.

Në analizë përse më sipër, Komisioneri prezumon faktin se ankuesja është trajtuar në mënyrë të diferencuar dhe diskriminuese, duke u mbështetur në faktin që:

Si pjesë e grupit të studentëve që kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve në institucionet private të arsimit të lartë me notën mesatare vjetore 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë), në ndryshim nga studentët që kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve në institucionet e arsimit të lartë publik, me notën mesatare vjetore 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë), nuk përfiton pagesën e tarifës studimore në ciklin e dytë të studimeve në IAL Publike, në masën 50% të saj.

Sa më sipër, në rastin në shqyrtim duket qartë që ka një lidhje mes trajtimit të diferencuar dhe të pafavorshëm me shkakun e mbrojtur. Në këtë moment, Komisioneri do të vlerësojë nëse një diferencë e tillë justifikohet objektivisht, pra specifikisht:

- A ndjek një qëllim legjitim?
- A janë mjetet e përdorura në mënyrë të arsyeshme, proporcionale me qëllimin e ndjekur?
- **A ndjek diferenca në trajtim një qëllim legjitim?**

Këshilli i Ministrave, nëpërmjet parashtrimeve të MASR-së, ka mbajtur qëndrimin se, parashikimi i lehtësimeve financiare për të ndjekur studimet në ciklin e dytë, të kategorive të caktuara të studentëve, është pjesë e politikës së përgjithshme shtetërore për mbështetjen e vazhdueshme të institucioneve publike të arsimit të lartë me fonde nga buxheti i shtetit, me qëllim për të siguruar arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës.

Po ashtu, propozimi për përcaktimin e kategorive të studentëve që ndjekin studimet në ciklin e dytë në institucionet publike të arsimit të lartë që përfitojnë nga e drejta e uljes së tarifave vjetore të studimit, është bërë me propozim të përbashkët të ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në mënyrë që të përcaktoheshin sa më drejtë kategoritë e studentëve përfitues, në proporcion edhe me mundësitë financiare të parashikuara në buxhetin e shtetit për të përballuar rimbursimin e IAL-ve publike, si rezultat i reduktimit të të ardhurave të këtyre institucioneve nga ulja e tarifës vjetore të studimeve për kategorinë e studentëve përfitues.

Referuar edhe rasteve<sup>24</sup> të tjera të trajtuara nga Komisioneri, vendosja e kriterëve të cilat vënë në pozita të pafavorshme dhe të pabarabarta, subjektet, në rastet kur këto masa nuk ndjekin një qëllim legjitim apo mjetet e përdorura për arritjen e qëllimit legjitim nuk janë të arsyeshme apo proporcionale, përbën një sjellje diskriminuese.

Në analizë të legjislacionit shqiptar cituar në vendim, duke nisur nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë si dhe ligji nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e

---

<sup>24</sup> Vendimi Nr. 41, datë 29.04.2020, i KMD-së, Vendimi nr. 94, datë 31.05.2021, i KMD-së.

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al), web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)



*arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, përcaktohet shumë qartë se e drejta për arsim mund të kushtëzohet vetëm nga kritere aftësie, si dhe qëllimi i ligjit nr.80/2015 është të garantojë mundësi të barabarta, mbi bazën e meritës, për të gjithë individët që duan të ndjekin studimet në arsimin e lartë.*

Vetë ligji nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, parashikon si qëllim të tij, të krijojë mekanizma të qëndrueshëm të sigurimit të cilësisë në institucionet e arsimit të lartë, në përputhje me standardet europiane; por njëkohësisht po ky ligj parashikon si një nga qëllimet e tij edhe të garantojë mundësi të barabarta, mbi bazën e meritës, për të gjithë individët që duan të ndjekin studimet në arsimin e lartë, pa diferencuar atë publik nga ai jopublik

Në këtë linjë, ky Ligj, në nenin 11 të tij, ka përcaktuar se Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL):

*“...është institucion publik në varësi të ministrisë përgjegjëse për arsimin, që ka për detyrë kryesore shpërndarjen e fondeve publike për:*

- a) mbështetjen e veprimtarisë së institucioneve publike të arsimit të lartë, ku përfshihet mësimdhënia, kërkimi shkencor dhe pjesëmarrja në çështjet e menaxhimit akademik dhe administrativ;*
- b) mbështetjen me bursa studimi për studentët e shkëlqyer me notë mesatare maksimale nga sistemi i arsimit të mesëm të lartë, studentët në programet e studimit në fusha prioritare dhe studentët nga shtresa sociale në nevojë;*
- c) garantimin e skemës së kredive studentore”.*

Neni 110<sup>25</sup>, i po këtij Ligji, ka përcaktuar se fondet nga Buxheti i Shtetit shpërndahen në formë granti, dhe një ndër kategoritë e përcaktuara në pikën 1/b) është edhe :

“ b) granti i mësimdhënies”.

“Granti i mësimdhënies”, sipas përcaktimit të nenit 112, përfshin:

*“ 1.a) fondin për institucionet publike të arsimit të lartë;*

*b) fondin e mbështetjes studentore”.*

*2. Fondi institucional u shpërndahet institucioneve publike të arsimit të lartë, sipas një formule që garanton mundësi të barabarta, drejtësi dhe transparencë.*

*3. Fondi i mbështetjes studentore përfshin tri kategori financimi: a) bursat e studimit për studentët e shkëlqyer; b) bursat e studimit për studentët në programet e studimit që përbëjnë prioritet kombëtar; c) bursat e studimit për studentët që i përkasin shtresave sociale në nevojë.*

*4. Bursat e studimit për studentët e shkëlqyer u jepen studentëve me notë mesatare maksimale në hyrje, në rang vendi, pavarësisht programit të studimit dhe institucionit, në të cilin ata kanë zgjedhur të ndjekin studimet. Studenti vazhdon të përfitojë nga ky grant nëse rezultatet e tij, gjatë gjithë viteve të studimit, vazhdojnë të jenë të shkëlqyera.*

---

<sup>25</sup> Neni 110 “Shpërndarja e fondeve nga Buxheti i Shtetit”.

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 243 1078, e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al), web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

5. Bursat e studimit për studentët që kanë zgjedhur të ndjekin programet e studimit në institucione publike të arsimit të lartë, që përbëjnë prioritet kombëtar, u shpërndahen studentëve që studiojnë në fushat e përcaktuara si të tilla me vendim të Këshillit të Ministrave.

6. Bursat e studimit për studentët që u përkasin shtresave sociale në nevojë u shpërndahen studentëve që janë shpallur fitues në institucionet publike të arsimit të lartë dhe plotësojnë kriteret për t'u konsideruar si studentë në nevojë, të përcaktuara si të tilla me vendim të Këshillit të Ministrave.

7. Ky grant shpërndahet nga AKFAL-i.

Bazuar në sa më lart, evidentohet qartazi se qëllimi i ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në frymë dhe në nen, është, të sigurojë mbështetje financiare të studentëve, bazuar në meritat e tyre lidhur me rezultatet e të nxënit<sup>26</sup>, pa u kushtëzuar nga institucioni në të cilin kanë përfunduar ciklin e mëparshëm të studimeve.

Për rrjedhojë, qëllimi i këtij Ligji, bazuar në përcaktimet e pikës 1/b) dhe pikës 3, të nenit 112, të tij, është të garantojë mbështetje specifike, për studentët e shkëlqyer, bazuar në rezultatet e tyre të të nxënit, si shpërblim dhe nxitje për rezultate të larta në vijimësi dhe jo për institucionet e arsimit të lartë.

Në analizë të parashtrimeve të KM-së është argumentuar si qëllim kryesor legjitim, detyrimi dhe për mbështetjen e vazhdueshme të institucioneve publike të arsimit të lartë me fonde nga buxheti i shtetit, me qëllim për të siguruar arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës, në kuadër të politikës së përgjithshme shtetërore.

Nga karahasimi i bërë ndërmjet këtyre dy kategorive përfituese të studentëve, Komisioneri konstaton se pikërisht parimi i gjithëpërfshirjes nuk është zbatuar në këtë rast.

Gjithashtu, nga analiza e të gjithë akteve ligjore dhe nënligjore, evidentohet se parimi që i udhëheq është se, politika kombëtare/shtetërore promovon në thelb trajtimin e barabartë në çështje, që lidhen me edukimin.

Për rrjedhojë, bazuar në sa më sipër, Komisioneri, trajtimin që VKM-ja i bën dy kategorive të studentëve, objekt krahasimi në këtë çështje, nuk e gjen të mbështetur në parimin për trajtim të padiferencuar dhe të barabartë.

Përrjashtimi dhe diferencimi që VKM-ja sipërcituar u bën kategorisë së studentëve të IAL Jopublike/Private, bazuar vetëm në faktin se kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve të larta, në këto institucione jopublike/private, është në kundërshtim me frymën dhe parashikimet në legjislacionin për arsimin e lartë.

*Lidhur me sa mësipër, Komisioneri vlerëson se:*

---

<sup>26</sup> Duke përfshirë në këtë kategori përfituesish, “studentët e shkëlqyer”, duke specifikuar pikërisht studentët që kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve të larta me mesatare vjetore 9 (nëntë) – 10 (dhjetë).

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 243 1078, e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al), web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

Përcaktimi i bërë në germen f) të pikës 1, të kësaj VKM-je, nuk përlligj faktin se vendosja kriterit përjashtues të tarifës vjetore të studimeve në masën 50%, për studentët që kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve në institucionet jopublike/private të arsimit të lartë, ka ardhur për arsye të ligjshme dhe të justifikuar objektivisht.

*“Gjendja arsimore” është një ndër shkaqet për të cilat, ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ofron mbrojtje nga diskriminimi. Neni 1 i këtij ligji parashikon: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Bazuar në nenin 6 të LMD, të ndryshuar, *“Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në raste kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përlligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi. Trajtimi i ndryshëm që bazohet në një karakteristikë të lidhur me shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, nuk përbën diskriminim kur për shkak të natyrës së aktiviteteve profesionale, ose të kushteve në të cilat profesioni ose veprimtaria ushtrohet, këto karakteristika përbëjnë një kërkesë të vërtetë dhe profesionale të domosdoshme, me kusht që qëllimi i trajtimit të ndryshëm të jetë i përlligjur dhe kërkesa të mos kapërcejë atë çfarë është e domosdoshme për realizimin e saj”*, Komisioneri vëren se, vendosja e kriterit të kategorisë së studentëve përfitues, me përcaktimin, që duhet të kenë përfunduar domosdoshmërisht, ciklin e parë të studimeve të larta në IAL Publike, nuk gjen aplikim te kjo dispozitë ligjore, pasi nuk ndjek një qëllim legjitim.

LMD, i ndryshuar, në nenin 17, të tij siguron mbrojtje nga diskriminimi në fushën e arsimit, duke përcaktuar se: *“Ndalohet çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji”.*

Komisioneri gjykon se kriteri përcaktues sipërcituar, për përfitimin e pagesës së tarifës vjetore të studimeve në masën 50% të saj, lidhet domosdoshmërisht më faktin që studentët që ndjekin ciklin e dytë të studimeve të larta, duket të kenë mbaruar ciklin e parë të studimeve të larta në IAL Publike, (pavarësisht faktit se kriteri i mesatares (9-10) është i njëjtë dhe plotësohet nga të dyja kategoritë njëlloj), dhe ka karakter diskriminues ndaj studentëve që kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve në IAL Jopublike/Private, duke i trajtuar haptazi ata në mënyrë të diferencuar dhe të pabarabartë.

Në analizë të sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, *diferenca në trajtim e studentëve që kanë mbaruar ciklin e parë të studimeve, me notë mesatare vjetore 9 (nëntë) – 10 (dhjetë) në IAL Publike dhe ndjekin ciklin e dytë të studimeve po në IAL Publike, me studentët që kanë mbaruar ciklin e parë të studimeve, me notë mesatare vjetore 9 (nëntë) – 10 (dhjetë) në IAL JoPublike/Private dhe ndjekin ciklin e dytë të studimeve në IAL Publike;.....nga ana e KM nëpërmjet pikës 1/f, të VKM-së sipërcituar, nuk ndjek një qëllim të ligjshëm dhe si pasojë nuk justifikohet objektivisht.*

Në përfundim të sa më sipër, Komisioneri gjykon se ankuesja, në referencë të nenit 7, pika 1, të ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, është ekspozuar para një trajtimi të padrejtë dhe diskriminues nga ana e VKM-së, lidhur me përfitimin nga përgjysmimi i tarifës vjetore të studimit, në programet e ciklit të dytë të studimeve në IAL, nëpërmjet vendosjes së kriterit që studentët përfitues duhet domosdoshmërisht të kenë mbaruar ciklin e parë të studimeve në IAL Publike. Përcaktimi i bërë në gërmën f), të pikës 1, të VKM në fjalë, i vë haptazi në pozita të pafavorshme ankuesen dhe gjithë kategorinë e studentëve që kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve në IAL Jopublike/Private, me mesatare nga 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë), për shkak të gjendjes së tyre arsimore, duke i ekspozuar ndaj një trajtimi të pabarabartë dhe të pa përligjur objektivisht, si dhe në kundërshtim me frymën dhe parashikimet e vetë ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Për rrjedhojë, Komisioneri vlerëson që, në gërmën f), të pikës 1, të kësaj VKM-je të hiqet fjala “publike”, dhe të reflektohet ndryshimi si më poshtë:

*“Studentët që fillojnë vitin e parë të ciklit të dytë të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë dhe që kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve në institucionet arsimit të lartë me notën mesatare vjetore 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë)”.*

## **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 18 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 1,2,5, të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, nenin 1, nenin 7, nenin 17, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, germa a) e nenin 33, pikat 10-11, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

## VENDOSI:

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të subjektit ankues, M. Q, nga ana e Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë Tiranë, për shkak të “*gjendjes arsimore*”.
2. Konstatimin e diskriminimit të subjektit ankues, M. Q dhe gjithë kategorisë së studentëve, të cilët kanë mbaruar ciklin e parë të studimeve të larta në IAL Private, me mesatare 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë), dhe ndjekin ciklin e dytë të studimeve të larta në IAL Publike, për shkak të “*gjendjes arsimore*<sup>27</sup>”, nga përcaktimi i pikës 1/f, të VKM nr. 780, datë 26.12.2018 “*Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit, në programet e ciklit të dytë të studimeve, në insitucionet publike të arsimit të lartë*”, nga ana e Këshillit të Ministrave.
3. Këshilli i Ministrave të rishikojë VKM-në nr. 780, datë 26.12.2018 “*Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit, në programet e ciklit të dytë të studimeve, në insitucionet publike të arsimit të lartë*”, duke ndryshuar germën f), të pikës 1, të saj<sup>28</sup>.
4. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijani për këtë vendim, Këshilli i Ministrave, të njoftojnë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e tij.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONER**

**Robert GAJDA**

Fusha: Arsimit  
Shkaku: Gjendja arsimore  
Lloji i vendimit: Diskriminimi i drejtëpërdrejtë

---

<sup>27</sup> Shih përcaktimin dhe shpjegimet e KMD-së në faqen 8, të Vendimit, nënndarja C - “Shkaku i mbrojtur”.

<sup>28</sup> Shih paragrafin e parafundit faqe 19, e vendimit. (“*Studentët që fillojnë vitin e parë të ciklit të dytë të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë dhe që kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve në institucionet arsimit të lartë me notën mesatare vjetore 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë)*”).